



Të folurit me fëmijët rreth

DETYRAVE TË SHTËPISË





DETYRAT E SHTËPISË

Pas një dite të gjatë në shkollë, Mariami, vajza juaj 9-vjeçare, bindet pa dëshirë për t'i përfunduar detyrat e shtëpisë. Pasi u përpoq për një kohë dhe pasi nuk arriti për të zënë hapin, ajo është tërësisht e irrituar dhe dëshiron t'i lë ato.

Kush nuk e njeh këtë situatë? Në shumë familje, problemet e detyrave të shtëpisë janë shpesh çështjet konfliktuozë numër një. Prindërit që dëshirojnë t'i nxisin dhe t'i shtyjnë përpara fëmijët e tyre, duan që ata t'i kryejnë detyrat e shtëpisë si duhet. Detyrat e shtëpisë konsiderohen si mundësi të rëndësishme të të mësuarit, të cilat fëmijët nuk duhet t'i anashkalojnë.

Sidoqoftë, nxënësit shpesh nuk janë të vullnetshëm që t'i kushtojnë shumë kohë të mësuarit akademik jashtë shkollës. Ata mund të mos i kuptojnë plotësisht detyrat dhe obligimet. Veç kësaj, ata nuk janë në gjendje të kërkojnë ndihmë nëse të dy prindërit janë në punë, ndërsa prindërit që duan të ndihmojnë shpejt kthehen në "mësues asistentë". Kështu, ata i kontrollojnë, ua kujtojnë dhe vendosin sanksione ndaj fëmijëve të tyre, nga shqetësimi se detyra mund të mos përfundojë ose të bëhet gabimisht. Si duhet të veprojnë prindërit në një situatë të tillë?

Zgjedhni nga këto reagime të mundshme, shihni se si gjërat mund të vazhdojnë dhe shihni sugjerimet që kemi për ju!




Shkoni te [faqja 2!](#)



Shkoni te [faqja 3!](#)

Në fund të dokumentit, në [faqen 6](#) ju do të gjeni këshilla të përgjithshme dhe sugjerime për t'u marrë me "detyrat e shtëpisë".




Nëse reagoni në këtë mënyrë, si nënë e saj, konflikti është i pashmangshëm. Mariam nuk po ia del me detyrat e saj të shtëpisë dhe, për më tepër, ajo e gjen veten të ballafaquar me qortimet tuaja. Ajo ndihet e keqkuptuar, ndërsa ju ndoshta nuk do ta duroni qëndrimin negativ dhe ngurrimin e saj. Ky konflikt mund të shmanget nëse do të përpiqeni t'i kundërviheni zemërimit të Mariamit me “komunikim të hapur”. Lexoni më shumë rreth komunikimit të hapur në [faqen 4](#).

Si mund ta “hapim” komunikimin tonë?

Së pari: Tregoni fëmijës suaj atë që keni kuptuar ose nxjerrë nga mesazhi i saj. Përmbahuni nga interpretimi i mënyrës së saj të folurit dhe të vepruarit. Vetëm jepni informata kthyesë në lidhje me atë që keni dëgjuar ose parë.

Së dyti: Duhet të bëni një përpjekje për t'i komunikuar hapur ndjenjat, mendimet, dëshirat dhe nevojat tuaja. Kini kujdes, mos i shprehni ato në mënyrë të nënkuptuar.

Së treti: Jepuni kohë të mjaftueshme dialogjeve dhe komunikimit në përgjithësi, duke i treguar kështu fëmijës suaj: “Ti je e rëndësishme për mua. Unë jam e interesuar për ty, për mendimet, emocionet, jetën tënde.” Kjo nxit një ndjenjë të thellë pranimi dhe mbështet vetëbesimin e fëmijës suaj.



Me këtë reagim, po përpiqeni t'i tregoni hapur perceptimet tuaja. Ju e dini se Mariami është e hutuar, por ju nuk e vlerësoni dhe e kritikoni sjelljen e saj. Kjo parandalon që ajo të ndihet e keqkuptuar dhe zhvlerësuar. Pushimi i shkurtër mund ta motivojë vajzën tuaj që t'i përfundojë me shpejtësi detyrat e saj, ose ju do të duhet të gjeni një zgjidhje tjetër të përshtatshme së bashku.

E rëndësishme është që të dyja të mbeteni të angazhuara në bashkëveprim pozitiv. Kështu, fëmija juaj do të kuptojë se kuptohet dhe pranohet. Ajo do të ndihet e fuqizuar t'i ndajë perceptimet dhe ndjenjat e saja pa pasur frikë se mund të ndëshkohet ose të mos pëlqehet. Kur komunikoni hapur me fëmijën tuaj, ju forconi vetëvlerësimin e saj. Të diturit e ndjenjave dhe mendimeve të saja, do t'i mundësojë vajzës suaj ta mendojë dhe vlerësojë veten në mënyrë kritike kohë pas kohe. Kështu, ajo do të jetë e pakufizuar nga ajo që të tjerët mund të mendojnë për të. Personalitetet me identitete të forta janë me rëndësi kritike dhe janë parakusht për funksionimin e demokracive.

Lexoni më shumë për komunikimin e hapur në [faqen 4](#).

Komunikimi i hapur

Komunikimi nuk bëhet vetëm me fjalë. Ne gjithashtu komunikojmë pa fjalë, me gjuhën e trupit (shprehjet e fytyrës, qëndrimin, gjestet). Për më tepër, theksi i zërit ndikon gjithashtu në mënyrën se si njerëzit e kuptojnë mesazhin tonë.

Më tej, 4 aspektet e ndryshme të një mesazhi (informacioni, marrëdhënia, apeli dhe vetë-zbulimi) duhet të merren parasysh kur përpiqemi të komunikojmë me sukses.

Përfundim: Nuk është e lehtë për ta transmetuar një mesazh në mënyrën se si dërguesi (në këtë rast Mariami) dëshiron të kuptohet dhe është akoma më e vështirë për marrësin të dekodojë kuptimin e synuar, siç dëshmohet nga pamundësia e nënës së Mariamit për ta kuptuar mënyrën e komunikimit të vajzës së saj.

Kështu, është e rëndësishme ta “hapim” komunikimin tonë. Komunikimi i hapur na lejon t’i qartësojmë aspektet e nënkuptuara të një mesazhi dhe siguron që nuk do ta keqkuptojmë njëri-tjetrin. Nganjëherë, edhe dërguesit nuk mund ta dinë qëllimin e vërtetë të një mesazhi ose sjelljeje të komunikuar. Për shembull, foshnjat dhe fëmijët e vegjël të cilët nuk janë në gjendje t’i përballojnë ndjenjat e tyre, kushtet e brendshme dhe nevojat, shpesh nuk e kanë aftësinë për t’i komunikuar ato qartë. Prandaj, prindërit ose të rriturit e tjerë duhet t’i gjejnë vetë këto (shembuj: A është fëmija i sëmurë apo i uritur? A është ndonjë gjë që shkakton dhimbjen e saj ose është vetëm e lodhur?). Situata me vajzën 9-vjeçare duket se tregon që ajo nuk është plotësisht në dijeni të nevojave të saj. Kështu, është sfidë e juaja prindërore që të përpiqeni t’i kuptoni fëmijët tuaj. Përpyekjet tuaja me komunikim të hapur mund të ndihmojnë në sqarimin e aspekteve të nënkuptuara të mesazhit të tyre.

Si mund ta “hapim” komunikimin tonë?

Së pari: Tregoni fëmijës suaj atë që keni kuptuar ose mbledhur nga mesazhi i saj. Përmbahuni nga interpretimi i mënyrës së saj të folurit dhe veprimit. Vetëm jepni informata kthyesë në lidhje me atë që keni dëgjuar ose parë.

Së dyti: Duhet të bëni përpjekje për të komunikuar hapur ndjenjat, mendimet, dëshirat dhe nevojat tuaja. Kini kujdes, mos i shprehni ato në mënyrë të nënkuptuar.

Së treti: Jepuni kohë të mjaftueshme dialogjeve dhe komunikimit në përgjithësi, duke i treguar kështu fëmijës suaj: “Ti je e rëndësishme për mua. Unë jam e interesuar për ty, për mendimet, emocionet, jetën tënde”. Kjo nxit një ndjenjë të thellë pranimit dhe mbështet vetëbesimin e fëmijës suaj.

Për mundësi praktikimi të komunikimit të hapur, vazhdoni leximin në [faqen 5](#).

Trajnim për komunikim të hapur

Këtu do të gjeni situata të ndryshme të jetës së përditshme me fëmijët. Në çdo rast, jepen dy reagime të ndryshme prindërore. Paramendoni se si do të vazhdojë ndërveprimi në përputhje me reagimin e deklaruar prindëror dhe shkruajeni.

Pastaj, reflektoni mbi ndërveprimet me ndihmën e pyetjeve të mëposhtme: Cili reagim prindëror çon në të kuptuarit më të mirë të fëmijës dhe situatës së saj? Si mund të gjejë fëmija një zgjidhje për problemin / situatën e saj? Si mund ta udhëheqë prindi fëmijën nëpër ndjenjat e nevojat e saj? Cili reagim prindëror çon në konflikt?

Në darkë²

Samanta 4-vjeçare, nuk dëshiron të hajë. Ajo vetëm çukit në patatet e saja.

A: “Samanta, mos u bëj ashtu si mbretëreshë drame! Haji patatet tuaja, ose do të shkosh në shtrat pa tregimin e gjumit”. Nëna flet me zë të lartë, me gishtin e ngritur, paralajmërues.	B: “Unë po e shoh se ti vetëm po çukit në ushqimin tënd dhe po shikon në pjatën tënde. Ti gjithashtu the se nuk do asgjë. Mendoj se je vetëm e lodhur dhe jo e uritur. A kam të drejtë?”
Si do të vazhdonte ky ndërveprim? <hr/> <hr/> <hr/>	Si do të vazhdonte ky ndërveprim? <hr/> <hr/> <hr/>

Të zgjuarit në mëngjes³

Olivia 10-vjeçare mbetet në shtrat dhe shpjegon: “Nuk mund të shkoj në shkollë sot.” Pas tri thirrjeve për t’u zgjuar, ajo ankohet: “Lërmë të qetë! Është e dhimbshme!”

A: “Ti nuk dukesh e sëmure, kështu që dil nga shtrati yt. Ne po ashtu duhet të punojmë, edhe kur nuk na pëlqen.”	B: (Imagjinoni reagimin në një situatë të komunikimit të hapur: Çfarë do të thoshte nëna?) <hr/> <hr/>
Si do të vazhdonte ky ndërveprim? <hr/> <hr/> <hr/>	Si do të vazhdonte ky ndërveprim? <hr/> <hr/> <hr/>

Koha e ushqimit

Stivi është 14 vjeç. Për dy javë, ai ka refuzuar të hajë darkë me pjesën tjetër të familjes së tij, duke pohuar: “Unë nuk jam i uritur!” Tani, babai i tij dëshiron që ai ta ndryshojë këtë sjellje.

<p>A: “Përderisa jeton me ne në shtëpinë tonë, ti duhet t’u bindesh rregullave tona. Dhe një nga rregullat thotë se ne hamë darkë së bashku. Tash, bashkangjitu me ne dhe zëre vendin tënd në tavolinë!”</p>	<p>B: (Imagjinoni një reagim në një situatë të komunikimit të hapur: Çfarë do të thoshte babai?)</p> <hr/> <hr/>
<p>Si do të vazhdonte ky ndërveprim?</p> <hr/> <hr/> <hr/>	<p>Si do të vazhdonte ky ndërveprim?</p> <hr/> <hr/> <hr/>

Këshilla dhe strategji për t’u marrë me çështjet e diskutueshme të “detyrave të shtëpisë”

Delegoni përgjegjësinë! Detyrat e shtëpisë janë një çështje mes mësuesve dhe nxënësve. Si prindër, shpesh mund të ushtroni pa vetëdije presion mbi fëmijët tuaj, sepse ndiheni përgjegjës për të ardhmen e tyre profesionale dhe gjithçka që ka lidhje me të. Mos u përfshini në betejë për pushtet, por delegoni përgjegjësinë për përfundimin e detyrave të shtëpisë te fëmijët tuaj. Në këtë mënyrë, ata mësojnë të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre dhe të bëhen më me vetëbesim në këtë proces. Sjellja dhe veprimi i përgjegjshëm është me rëndësi jetike për fëmijët tuaj si qytetarë të ardhshëm, të pavarur në një shoqëri demokratike.

Kur detyrat e shtëpisë marrin shumë kohë... Kjo mund të ndodhë për arsye të ndryshme. Ndoshta detyrat janë të paqarta, ose nxënësit kanë keqkuptuar diçka. Megjithatë, fëmijët herë pas here kërkojnë vëmendjen e dobishme të prindërve të tyre, duke kuptuar se “kur kam vështirësi, prindërit e mi do të vijnë dhe do të ma kushtojnë kohën dhe vëmendjen”. Prapëseparë, shumë fëmijë janë të mbingarkuar me detyrat e shtëpisë dhe kështu bëhen të dekurajuar dhe të irrituar. Mundohuni të kuptoni shkakun për kohën e tepërt të shpenzuar për detyrat e shtëpisë, pastaj veproni në përputhje me rrethanat.

Ndërprerjet e vogla janë thelbësore! Nëse mendoni se fëmijët tuaj duken shpesh të irrituar me detyrat e shtëpisë ose të mbytur me një mori detyrash pa një plan pune, duhet ta zhvillonin një orar detyrash së bashku me fëmijët tuaj. Mos e mbivlerësoni aftësinë e tyre për t’u përqendruar dhe planifikoni ndërprerje të shkurtra pushimi në orarin e punës së fëmijëve tuaj.

Detyrat e shtëpisë si shtytës për konflikte të tjera? A ndihen fëmijët tuaj të trajtuar padrejtësisht nga mësuesit e tyre? A ka probleme në shkollë? A ndihen fëmijët tuaj të keqkuptuar? Çështjet me detyrat e shtëpisë mund të lindin edhe për arsye të tjera. Kushtoni kohë për të kuptuar ndjenjat e fëmijëve tuaj dhe merrni seriozisht ato. Ju mund të gjeni sugjerime të dobishme dhe me vend në seksionin “komunikimi i hapur” në [faqen 4](#).

Bisedoni me mësuesit e fëmijëve tuaj. Nëse mendoni se fëmijët tuaj kërkojnë shumë kohë për detyrat e shtëpisë ose nëse ka çështje të tjera që lidhen me detyrat e shtëpisë, kontaktoni drejtpërdrejt mësuesit e tyre dhe diskutoni me kohë pyetjet dhe çështjet tuaja. Kështu, pasiguritë mund të adresohen para se fëmijët tuaj të bien në dëshpërim për detyrat e tyre dhe të lindin konflikte më të mëdha në shtëpi.

“Të folurit me fëmijët rreth detyrave të shtëpisë” është bazuar në referencat më poshtë:

¹ Heueck-Mauss, Doris. 2016. *So rede ich richtig mit meinem Kind: Wie Worte wirken: Konflikte fair lösen: Stressfreier erziehen*. Hannover: Humboldt, 33 ff.

² Heueck-Mauss, Doris. 2016. *So rede ich richtig mit meinem Kind: Wie Worte wirken: Konflikte fair lösen: Stressfreier erziehen*. Hannover: Humboldt, 32.

³ Heueck-Mauss, Doris. 2016. *So rede ich richtig mit meinem Kind: Wie Worte wirken: Konflikte fair lösen: Stressfreier erziehen*. Hannover: Humboldt, 44.

Braun, Liselotte. 2017. “Knatsch bei den Hausaufgaben- das muss nicht sein.» *Das Schweizer Elternmagazin Fritz und Fränzi*, April, 18-19.

Council of Europe. 2016. *Competences For Democratic Culture. Living together as equals in culturally diverse democratic societies*. Strasbourg: Council of Europe Publishing, 41 f.

Heueck-Mauss, Doris. 2016. *So rede ich richtig mit meinem Kind: Wie Worte wirken: Konflikte fair lösen: Stressfreier erziehen*. Hannover: Humboldt, 25 ff.